



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga ëAbdi Toptanië, nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 20/12/2018

V E N D I M

Nr. 220, Datë 20/12/2018

PËR
AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË
MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË ëMBI REFLEKTIMIN NË
KONTABILITET DHE PASQYRA FINANCIARE TË AKTIVITETIT TË
PROGRAMEVE BUXHETORE TË CILAT NË ZBATIM TË VKM-VE PËRKATËSE
KALUAN NË PËRGJEGJËSINË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nga auditimi Tematik ëMbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, konstatohet se, në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, janë reflektuar aktivitetet e aparateve të ish-Ministrisë së Zhvillimit Urban, ish-Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe ish-Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, aktivitete të cilët gjatë vitit 2017, në zbatim të VKM-së nr. 504, datë 13.09.2017, kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 ëPër Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të auditimit Tematik ëMbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas programit të auditimit nr. 1040/1, dt. 17.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 31.12.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rezulton të ketë kryer konsolidimin e Pasqyrave Financiare si pasojë e përthithje së aktiviteti nga aparatet të cilat u shkrinë si pasojë e ndryshimit të fushave të përgjegjësisë. KLSH ka konstatuar se bashkimi është kryer në bazë të raportimeve të secilës njësi individuale të aparatit të ish-MZHU, ish-MEI dhe ish-MTI për aktivitetin 11-mujor dhe pasqyrave financiare deri në Nëntor 2017.

Nga auditimi u konstatua se, në Pasqyrat Financiare të MIE për vitin 2017, nuk është reflektuar shtesa e aktiveve të transferuar nga ish Ministria e Mjedisit në vlerën **2,141,404 mijë lekë** për dy projekte të cilat referuar Aktit Normativ nr. 02, datë 06.11.2017, kaluan në administrimin e MIE.

a) Në lidhje me projektin e investimit Ndërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë përgjatë periudhës 10 muajore Janar-Tetor 2017, nga ish Ministria e Mjedisit janë kryer pagesa në vlerën 505,262 mijë lekë, ndërkohë që ky projekt me Akti Normativ nr.3, datë 06.11.2017, kaloi në administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Konstatohet se, për periudhën Dhjetor 2017, në lidhje me këtë projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë kryer pagesa në vlerën 131,309 mijë lekë.

b) Në lidhje me projektin e investimit Dhënie me koncesion e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie konstatohet se, përgjatë periudhës 10 muajore Janar-Tetor 2017, nga ish Ministria e Mjedisit janë kryer pagesa në vlerën 590,000 mijë lekë, ndërkohë që ky projekt me Akti Normativ nr.3, datë 06.11.2017, kaloi në administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Konstatohet se, për periudhën Dhjetor 2017, në lidhje me këtë projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë kryer pagesa në vlerën 162,770 mijë lekë.

Referuar sa më lart, konstatohet se, financimi i këtyre dy projekteve koncensionare është kryer nga programi 5320 Programe për mbrojtjen e mjedisit o i ish Ministrisë së Mjedisit për 10 muajt e parë të vitit, në vlerën totale 1,095,262 mijë lekë dhe për 2 muajt e tjerë të vitit financimi i këtyre dy projekteve është kryer nga programi 6220 Menaxhimi i mbetjeve urbane" të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në vlerën 294,079 mijë lekë.

Pra Akti Normativ nr.3, datë 06.11.2017 bëri të mundur copëtimin e investimit të vitit dhe investimit total të mbartur në vite duke kaluar investimet nga njëra ministri në tjetrën, megjithëse Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë **nuk rezultojnë të jenë të përfshira në konsolidime ndërmjet njëra tjetrës** (programi 5320 Programe për mbrojtjen e mjedisit o i Ministrisë së Mjedisit, nuk ka kaluar në MIE, por në MIE kanë kaluar vetëm projektet e investimit të lartpërmendur pjesë e këtij programi). Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit vlera e këtyre aktive është pakësuar për 2,141,404 mijë lekë referuar pagesave të bëra në lidhje me këto investime, ndërkohë që kjo shtesë aktivesh **nuk është pasqyruar në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**.

1.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Strukturat Përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit:

a) të marrë masat e nevojshme në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të plotë të transferimit të aktiveve pa pagesë referuar legjislacionit në fuqi, për dy projektet e investimit Ndërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë dhe Dhënie me koncesion e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie.

b) të marrin masa për kontabilizimin e vlerës së këtyre Aktiveve të Trupëzuara, bazuar në rakordimin e bërë ndërmjet dy ministrive në lidhje me pagesat e kryera për këto projekte në mënyrë që pozicioni financiar i institucionit në mbyllje të periudhës ushtrimore të paraqitet në mënyrë të drejtë dhe pa anomali.

Brenda vitit 2018

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi **reflektimin në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)** të programeve buxhetore, të cilat në zbatim të VKM-^{ve} përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të saj, si dhe rakordimi i planit të buxhetit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në mbyllje të periudhës ushtrimore të vitit 2017, rezultoi:

a. Diferenca e planit me ndryshime për gjithë programet e grupit 6 (MIE) me aktin normativ nr.3, në krahasim me planin me ndryshime me aktin normativ nr.2, rezultoi në vlerë 9,707,242 mijë lekë, ndërsa shuma e shkresave të alokimit të këtij akti normativ është në vlerë 5,129,295 mijë lekë, pra me një diferencë midis tyre për 4,577,947 mijë lekë, diferencë e cila duhet të jetë e barabartë me alokimet nga përdorimi i fondeve me VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit dhe Fondeve të Kontigjencave (pra VKM të rritjes së pagave dhe shkresa të ministrit të financave dhe ekonomisë për përdorimin e fondit të veçantë të pagave). Ky institucion nuk na e vërtetoi diferencën prej **4,577,947 mijë lekë** me VKM dhe shkresat e ministrit.

b. Të dhënat dhe tabelat plotësuese të Raportit të Monitorimit për vitin 2017, janë dorëzuar në MFE me shkresën nr.1615/2, datë 28.02.2018, ndërsa përgjigja e MFE për këtë raport nuk na u vu në dispozicion. Plotësimi i Raportit të Monitorimit **nuk është bërë duke reflektuar** për 4 programet e përthithura, pra me vlerat e aktit normativ nr.3, por si në plan dhe në fakt tabelat e Raportit të Monitorimit, janë plotësuar vetëm për shumat e planifikuara dhe realizuara të muajit dhjetor 2017.

c. Në raportet e monitorimit nuk është pasqyruar se nga se ka ardhur ndryshimi në programin 06220 ÷Menaxhimi i mbetjeve urbane, megjithëse ky ndryshim është se këtij programi i janë shtuar dy projekte investimi nga Ministria e Mjedisit të programit 5320 ÷Programe për mbrojtjen e mjedisit, me aktin normativ nr.3.

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të MIE/Strukturat që merren me programimin dhe Monitorimin e Buxhetit të argumentojnë ndryshimet në buxhetin e vitit 2017, në mënyrë që plani me ndryshime të jetë i barabartë me Aktin e fundit normativ të zbatimit të Buxhetit dhe VKM-^{të} e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, apo Fondit të Kontigjencave, me qëllim që Raportet e Monitorimit të Buxhetit të pasqyrojnë drejt programimin, domosdoshmërinë dhe ligjshmërinë e ndryshimeve të tij gatë vitit buxhetor, si dhe saktësinë e realizimit të buxhetit me programe e produkte.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi **miratimin e strukturës së re organike të MIE** dhe marrjes në ngarkim të detyrave pas procesit të përthithjes së veprimtarisë të programeve buxhetore, rezultoi se procesi i ristrukturimit të ministrive është shoqëruar me problematika si më poshtë:

- Një pjesë e nëpunësve janë larguar apo ripozicionuar pa dorëzuar detyrën në përputhje me dispozitat ligjore;
- Struktura e re e miratuar më datë 05.10.2017 është bërë efektive në janar 2018, duke krijuar shpenzime joefektive page në muajin dhjetor për 27 nëpunës të paguar mbi strukture;
- Nuk është miratuar rregullorja e re e institucionit pas ristrukturimit;
- Konstatohet në strukturë një numër i lartë vendesh vakante;

3.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të MIE/Nëpunësi Autorizues i këtij institucioni të marrë masat për:

- a. Hartimin dhe miratimin e rregullores së re të institucionit;
- b. Plotësimin e dokumentacionit me proces verbalet e dorëzimit të detyrës për të gjithë nëpunësit e larguar apo transferuar;
- c. Identifikimin e përgjegjësive për shpenzimet joefektive të pagave mbi strukturën e miratuar në muajin dhjetor 2017 për 27 nëpunës;
- d. Plotësimin e vendeve vakante në funksion të rritjes së performancës së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. Çështje të tjera:

- a. Pasqyrat financiare të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të periudhës 01.01.2017 deri në 31.12.2017 janë audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr. 1010/1, dt. 07.09.2018.
- b. Lloji i opinionit të shprehur nga audituesit është *opinion i pakualifikuar me rezervë* sipas vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 172, dt. 30.11.2018 dërguar MIE me shkresën nr. 1010/6, dt. 30.11.2018.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R